



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u> Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-3610/14</u> Prot. No. Data Datum <u>15-10-2014</u> Date PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.10.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-2933/14, për zyrtarin e lartë z. Ajet Demiri, Anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas , për shkak se zyrtari i lartë publik nuk është në gjendje të konfliktit të interesit si fitues i tenderit për ndërtimin e zyrës për konsumatorë në Prishtinë, nga Ndërmarrja e Ujësjellësit Rajonal Prishtina Sh.A, ndërsa pas zhvillimit të procedurës është kërkuar të bartë menaxhimin e Ndërmarrjes te një person i besuar, i cili me ndryshimin e bërë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit në të cilin ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ajet Demiri, Anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në biznesin privat N.N. "Proing, dhe fitues i tenderit nga Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina" Sh.A, për ndërtimin e zyrës për konsumatorë në Prishtinë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është njoftuar për situatën në të cilën ndodhet, të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit

Zyrtarit i lartë z. Demiri, i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik, si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksion menaxhes në biznesm privat, dhe për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, duhet të bartë menaxhimin e biznesit te një person i besuar (jo person i afërt).

Zyrtari i lartë ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë, zyrtari i lartë z. Demiri ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 3383/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti është larguar nga të qenurit person i autorizuar në biznesin privat N.N. "Proing".

Ndërsa, sa i përket kontratës së fituar nga Kompania e Ujësjetës Rajonal "Prishtina" Sh.A, për ndërtimin e zyrës për konsumatorë në Prishtinë, me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit një situatë e tillë nuk paraqet Konflikt Interesi.

Rjedhimisht, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Ligji nr.04/L-051, parasheh situatat me konflikt interesi të lidhjes së kontratës, konkretisht neni 15 (paragrafi 5), i këtij Ligji shprehimisht thotë:

Ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar, nuk ka të drejtë të lidhi kontrate ose të përfitoj ndihme nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë është në pozite vendimmarrëse.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

